



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 544/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci” nr.1, kundër debitorit NTSH “Xh...” me NRB ..., me seli në Pejë, rr. Nënë Tereza, nr. 54, me pronar Xhevdet Kurbogaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 507/2020, të datës 12.10.2020 të Përbaruesit Privat Jeton Krasniqi me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 09.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit NTSH “Xh...”, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 507/2020, të datës 12.10.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr. 507/2020, i datës 12.10.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi.

A r s y e t i m

Kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka parashtruar propozim për përbarim kundër debitorit NTSH “Xh...” me seli në Pejë, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përbarues - Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.3602 të datës 15.10.2018, i formës së prerë prej datës 24.01.2019 dhe i ekzekutueshëm prej datës 09.02.2019, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës t’ia paguaj shumën prej 14,961.50€ (katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një euro e pesëdhjetë cent) në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirlogarinë Nr. ... .

Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datë 12.10.2020, ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 507/2020, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues-

Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.3602, të datës 15.10.2018 me të cilën është urdhëruar debitori që t'ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 14,961.50 € (katërbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një euro e pesëdhjetë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhet shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifat në fuqi.

Debitori NTSH "Xh..." brenda afatit ligjor, përmes të autorizuarit të tij, shoqërisë së avokateve "SCLR Partners", me seli në Prishtinë, ka paraqitur prapësim me shkrim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor për arsyet se aktvendimi nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe nuk ka titull ekzekutiv, dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 71 par.1.1 të LPP-së. Më tutje ka theksuar se urdhri përbarimor është i parakohshëm dhe i njëjti nuk është i përbarueshëm pasi që ndaj aktvendimit në bazë të së cilit është lëshuar urdhri përbarimor është paraqitur konflikt administrativ me datën 14.02.2019 dhe ka konsideruar se akti nuk ka efekt juridik dhe se ende nuk ka arritur përbarueshmëria pasi që ndaj të njëjtit vendim ende vihet në dyshim çështja e ligjshmërisë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor.

Kreditori me përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova duke shtuar se në bazë të nenit 69 par. 5 të LPP-së, prapësimi mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të LPP-së, i cili duhet të mbështetet në prova të duhura. Ka shtuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim më tepër janë deklarative se sa të mbështetura në prova dhe argumente për faktin se në përputhje me nenin 27 par.1 të LPP-së, në dokumentin përbarimor është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet shuma dhe koha e përmbushjes. Ndërsa lidhur me pretendimin e debitorit se lidhur me këtë çështje është paraqitur padi për konflikt administrativ, kreditori ka deklaruar se dokumenti përbarues është titull ekzekutiv, i njëjti është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, ndërsa duke u bazuar në nenin 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ përcaktohet se padia nuk e ndalon ekzekutimin e

vendimit përkatësisht përmbartimin e këtij aktvendimi. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin Nr.3602 të datës 15.10.2018, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Vendimi Nr.3602 i datës 15.10.2018, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.3602 i datës 15.10.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.3602 i datës 15.10.2018, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 24.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 09.02.2019.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, mirëpo gjeti se vendimi Nr.3602 i datës 15.10.2018 përbën dokument përmbartimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “ *Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*”, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: “*Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbartimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbartimin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.544/22, datë 09.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.